

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SELA AIR CONDITIONING" Sh.P.K.

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, ne Tirane, me date 08 Maj 2023, Z.Fatian Sela i datelindjes 05.06.1989 lindur ne Maminas e banues ne Tirane, madhore me zotesi te plote per te vepruar ,identifikuar me ane te leternjoftimit me nr personal I90605015P, i cili me cilesine e ortakut themelues me vullnet te lire, te plote e te sinqerte, mbeshtetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise ne Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, "**Sela Air Conditioning**"

Kreu I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "Sela Air Conditioning", eshte person juridik i se drejtes shqiptare. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me poshte e quajtur "Shoqeria".

Neni 2

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Rruga Dalip Topi, rezidenca Platea, ndertesa nr 2. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege te krijojte filiale si dhe brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 3

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohorete papercaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise:

Sherbime te ndryshme lidhur me tregtimin, montimin, servisimin dhe zevendesimin te zgjidhjeve industriale dhe konsumatore te pajisjeve te kondicionimit, ftohjes dhe ngrohjes. Punime dhe instalime elektrike dhe hidraulike.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 ALL (njqind leke) dhe zoterohet teresisht nga ortaku themelues zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme (100 lek), qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise. Kontributi i ortakut eshte ne para. Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime. Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane tek ontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogëlimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme nepermejt bashkeshorteve i dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve nepermjet akteve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe teraporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqësimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetet apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Per sa kohe qe kapitali themeltar i Shoqerise zoterohet nga nje ortak i vetem, ky i fundit do te ushtroje kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 9

Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.


Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Nerastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet për shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.



Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, përfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13

Administrimi


Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te Shoqerise.

Ortaku i vetem vendos pr sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore,percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/et mund te jene ose jo ortake te shoqerise.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte Z.Fatian Sela me nje afat 5 vjecar.



Kreu IV
Viti financiar, Llogarite Vjetore, Fitimet dhe Rezervat Ligjore

Neni 14
Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 15
Rezervat Ligjore

Shoqeria do kaloje ne fondin rezerve te detyrueshme te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 16
Dividentet

Pas miratimit te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

Kreu V
PRISHJA – LIKUIDIMI

Neni 17
Prishja e shoqerise

Prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe: kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit; ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykates. Ose kur shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 vjet dhe nuk eshte njoftur pezullimi i veprimtarise ne QKB ose per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 18
Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.

Neni 19

Dispozita perfundimtare

Ky statut u hartua ne ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhe n shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku Themelues i shoqerise "**Sela Air Conditioning**" nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin,mbiemrin dhe firmen e tij origjinale.

ORTAKU I VETEM

Fotian Sela
